



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:258311

Datë: 08.12.2023

Numri i dokumentit: 05038714

C-IV-14-6472

Ankuesi

R O, Fshati P, Vushtrri.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me 07 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Ankuesi i bartë shpenzimet gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 09 tetor 2014, ankuesi parashtrij ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit MIT042-0688 të datës 29 korrik 2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për paga të pa paguara në shumë prej 9,530.00 €, nga NSH “Çyçavica” (në likuidim). Së bashku me ankesën ai ka bashkëngjitur kopjen e vendimin e kundërshtuar.

Me 03 nëntor 2023, gjykata lëshoi vërejtjen për pagesën e taksave gjyqësore.

Zarfi është dërguar nga punonjësi i postës dhe i është lënë raport me 06 dhe 14 nëntor 2023, duke theksuar se “tentim dorëzimi është bërë, por marrësi është jashtë vendit”. Me datën 15 nëntor 2023 është tentuar përsëri të dërgohet vërejtja në adresën e njëjtë, por në raportin e lëshuar nga posta me datë 27 nëntor 2023 thuhet “tentim dorëzimi bërë, por marrësi është në perëndim”.

Mirëpo, përkundër dy tentimeve me dt. 06 nëntor 2023 dhe 15 nëntor 2023 për t'i dorëzuar urdhrin, nga ana e shërbimit postar është konstatuar se përkundër raporteve të lëna, ankuesi asnjëherë nuk i është përgjigjur ftesës për të pranuar urdhrin.

Gjykata, ka publikuar në tabelën e shpalljes urdhrin prej datës 27.11.2023 deri me datën 05.12.2023.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Ankuesi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh:

Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Me dt. dt. 06 nëntor 2023 dhe 15 nëntor 2023, Gjykata përmes urdhrin kërkoi nga ankuesi që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk bënë pagesën e taksës.

Vërejtja e Gjykatës të dt. 06 nëntor 2023 dhe 15 nëntor 2023, asnjëherë nuk i kishte pranuar, por, në adresën e dhënë 2 herë i ishte lënë raporti nga shërbimi postar.

Sipas nenit 116.1 të LPK-së, pala ose përfaqësuesi i saj, në qoftë se gjatë zhvillimit të procedurës apo para se të kalojë afati prej gjashtë muajsh pas përfundimit të procedurës me vendim të formës së prerë, e ndërrojnë adresën në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave kanë për detyrë që për këtë gjë ta njoftojnë menjëherë gjykatën, në rastin konkret gjykata ka tentuar ta

dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.
dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), ankuesi si palë e pasuksesshme do të mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrie Shala